



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

*Shtator, 2018*

**Kryeministri Haradinaj u takua me përfaqësuesit e SBASHK-ut**



**Edhe një takim tjetër i rëndësishëm në Bruksel**

Sindikatat e Arsimit të Evropës në përkrahje të veprimeve të SBASHK-ut


Krahas angazhimit dhe kontributit në Konferencën "Forcimi i kasindikatr ... (faqe 8)

## Me angazhime të përbashkëta për korrigjim në Projektligjin e pagave

Duke vazhduar me përpjekjet që të bëhen korrigjime të Projektligjin për pagat në mënyrë që të punësuarit në sektorin e arsimit të kenë vend merit, një delegacion i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rahman Jasharaj është pritur sot nga Kryeministri Haradinaj. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe Ministrat Mahir Jagcilar e Shyqiri Bytyqi.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut i kanë ... (faqe 5)

**Intervistë me prof. Besa Hoxha Krasniqi .**



Është krenari të jesh mes mësimdhënësish në aktivitetet e SBASHK-ut

Besa Hoxha Krasniqi është e pasionuar në ... (faqe 3)

**Në Bruksel një ngjarje e veçantë për sindikatat e arsimit të Evropës**



**Zë i fortë e unik në mbrojtje të profesionit të mësuesit**

Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës vazhdon me realizimin ... (faqe 6)

**Takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit**



**Edwards përgëzon SBASHK-un për përkushtimin dhe arritjet**

Pjesëmarrja në Konferencën "Forcimi i kapaciteteve të sindikatave të arsimit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### Miku i madh i SBASHK-ut



Ishte mbresëlënëses takimi në Bruksel me sekretarin e tanishëm të Internacionales Botërore të Arsimit, z. David Edwards . Biseduam lirshëm për të gjitha çështjet aktuale në arsim. Delegacioni i SBASHK-ut kishte mundësi nga afër t'ia urojë atij detyrën e sekretarit të përgjithshëm dhe të shpreh respekt për punën e madhe që kishte bërë paraardhësi i tij në këtë detyrë z. Fred Van Liven.

Edwards i bëri pritje të ngrohtë delegacionit të SBASHK-ut dhe i erdhi fort mirë për dhuratën , që ishte portreti i tij i skalitur në pëlhurë nga një mësues i mirë i artit nga Mitrovica.

“Duke ma dorëzuar detyrën z. Liven me këshilloi që të angazhohem pa u ndalur në përkrahje të sindikatave të arsimit kudo në botë, por për SBASHK-un të kesh kujdes të veçantë”, u shpreh me emocione Edwards duke premtuar se këtë këshillë do ta ketë në kujdes vazhdimisht.

Fredi është tani në pension, por ka mbetur mik i madh i SBASHK-ut. Ai në vitet e okupimit erdhi shpesh në Kosovë për të parë nga afër angazhimin sublim që po bënin mësimmshënësit në mbrojtje të dritës nga errësira. Ai nëpër vite e dekada ishte zë i fuqishëm i mësuesit shqiptar të Kosovës kudo në takime të rëndësishme nëpër botë e në të cilat flitej për arsimin.

Fredi mbetet mik i arsimit në botë, ishte dhe mbetet mik i madh i SBASHK-ut.

Të faleminderit Fred.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)**  
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

### Intervistë me prof. Besa Hoxha Krasniqi



Është krenari të jesh mes mësimdhënësish në aktivitetet e SBASHK-ut

Besa Hoxha Krasniqi është e pasionuar në profesionin e mësimdhënësës së gjuhës shqipe. Ajo ka arritur titullin maestr. Ishte edhe zë i qytetarëve të asamblenë e komunës së saj. Besa është

shembull i mirë i angazhimit dhe kontributit edhe në aktivitetet sindikale. Ajo është e palodhur edhe në trajnimet që po organizon SBASHK-u sipas kërkesës së anëtarësisë nëpër komunat e Kosovës. Ajo me kënaqësi pranoi të përgjigjet në pyetjet e gazetës sonë.

#### **Arsimimi sot:**

Kush është Besa Hoxha Krasniqi?

#### **Besa:**

Kam lindur ne fshatin Krajkovë të Drenasit. Shkollën fillore dhe të mesme e kam mbaruar ne Drenas. Më pastaj kam mbaruar studimet ne Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Filologjisë, dega Letërsi shqipe. Pas kësaj kam vazhduar me studimet për të arritur te titulli master i shkencave të filologjisë, drejtimi arsimor në Universitetin e Prishtinës. Jam e martuar dhe jam nënë e dy fëmijëve Dorelës dhe Kronit. Punoj në gjimnazin “Ismail Qemajli” në Kamenicë.

#### **Arsimimi sot:**

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot?

#### **Besa:**

Me një përvojë 18-vjet në arsim, e pasionuar pas profesionit për çdo arritje dhe për realizimin e objektivave, vazhdimisht mundohem të përmirësoj dhe kualifikoj veten në çdo drejtim të mësimdhënies dhe edukimit, si detyrë që duhet dhënë vetes në misionin fisnik dhe human që e kemi, duke shpalosur para nxënësve cilësi e vlera, praktika dhe strategji të

suksesshme, për ta bërë lëndën sa më tërheqëse, dhe sa më të lehtë për ta kuptuar është sfida e vërtetë e që më pastaj krejt kjo do të reflektohet nga nxënësit, përmes respektit, mirënjohjes dhe konsideratës dhe kur arrihet kjo harrohen vështirësitë.

#### **Arsimimi sot:**

Cili është roli momental i femrës mësimdhënëse në SBASHK?

#### **Besa:**

Sot, fatmirësisht demokratizimi i sistemit ka ndikuar pozitivisht edhe në demokratizimin e familjes e shoqërisë. Është pozitive dhe për t'u vlerësuar përkushtimi i madh në emancipimin e femrës. Ne sot kemi femra deputete, ministre, udhëheqëse në shumë segmenteve të rëndësishme institucionale, por hapësira në pozita menaxhimi është e vogël në të gjithë sektorët, por edhe brenda SBASHK-ut krahasuar me atë se gjysma e popullsisë janë femra. Jeta ka sfida dhe sakrificë, por ne nuk duhet të presim shumë nga mëshira e burrave se a do të na hapin rrugë, por duhet ta përkrahim njëra-tjetrën. Duhet të jemi më motivuese dhe pretenduese në karrierën tonë sepse shoqëria jonë ka nevojë më shumë për ne.

#### **Arsimimi sot:**

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?

#### **Besa:**

Me theks të veçantë do veçoja kthimin e besimit të anëtarësisë dhe gjithë të punësuarve në arsimin e Kosovës në SBASHK, i cili besim në konteste të caktuara kohore ishte i luhatur. Arritje shumë e madhe është Kontrata kolektive, pjesëmarrja në hartimin e ligjeve dhe avokimi i kërkesave të mësimdhënësve dhe gjithsesi pagesa nga 0.50 euro të përvojës së punëtorëve.

**Arsimimi sot:**

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta?

**Besa:**

Mbrojtja e dinjitetit të mësimitdhënësve, përfshirë këtu pozitën materiale dhe krijimin e kushteve më të mira në punë ,angazhimin maksimal për të arritur dhe aprovuar ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

**Arsimimi sot:**

Si ndiheni si trajnere e dy programeve të SBASHK-ut, në trajnimet me mësimitdhënësit?

**Besa:**

Është ndjenjë shumë pozitive dhe privilegj të jesh trajnere e SBASHK-ut ,ngase në të gjitha trajnimet dhe grupet kam pasur ndjenjën e krenarisë mbi arsyet , sqarimet e shkoqitura për të mirat që ofron organizata jonë -SBASHK-u për anëtarësinë. Ky fakt ka shërbyer për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë si dhe informacione reja për të pranishmit.

**Arsimimi sot:**

Çka të shtyri të angazhohesh si trajnere në SBASHK-ut?

**Besa:**

Etika ime në punë,parimet e mia bazuar në drejtësinë shoqërore ,prirja dhe shkathtësia për dialog dhe komunikim ,zgjedhje të konflikteve në mesin ku kam punuar ,shkeljet e të drejtave të punëtorëve arsimorë dhe dëshira për punë vullnetare ishin motivet e mia.

**Arsimimi sot:**

Çka i sugjeron mësimitdhënësve që nuk janë aktivë sa duhet në SBASHK?

**Besa:**

Në të gjitha punëtoritë në të cilat kam marrë

pjesë,diskutime ,negociata por edhe në biseda formale dhe jo formale me punëtorët arsimor i sugjeroj t'i përcjellin të arriturat e SBASHK-ut,t'i analizojnë rezultatet e Kontratës Kolektive dhe ta lexojnë atë ,t'i shtrojnë në forumet e tyre idetë dhe kërkesat ,të marrin pjesë aktive duke filluar nga aktivi ku punojnë t'i drejtohen organeve gjegjëse në SBASHK me rastin e shkeljeve së të drejtave të tyre.

**Arsimimi sot:**

Çka do të veçonit nga trajnimi I mbajtur në Kamenicë?

**Besa:**

Mësimitdhënësit e Kamenicës i besojnë SBASHK-ut. E them këtë me plot përgjegjësi dhe do e përmendi një fakt të veçantë gjatë procesit të rilicencimit të mësimitdhënësve në komunën e Kamenicës për licencën e karrierës kishim vërejtur se shumë mësimitdhënës nuk i posedonin orët e nevojshme të trajnimeve për marrjen e licencës në baze të kriterit të UA :5/2017 dhe në bashkëpunim me SBASHK-un organizuam trajnimin e akredituar “ Forcimi I kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social “ dhe shumë nga mësimitdhënësit arritën t'i grumbullojnë pikët e nevojshme.

**Arsimimi sot:**

A keni diçka për të shtuar?

**Besa:**

Po. Mendimi im është që të mbahen në të gjitha komunat trajnimet që SBASHK-u I ka programet e akredituara sepse vërtetë ka nevojë. jo vetëm për kryetarët, apo anëtarët e Këshillit Drejtues, por edhe për anëtarët tjerë në çdo cep të Kosovës ngase vetëm kështu e shtrijmë edhe më mirë organizimin dhe barten informatat e duhura për të drejtat e mësimitdhënësve dhe për angazhimet, sfidat dhe arritjet e SBASHK-ut. Më besoni se ky angazhim është vazhdimisht i nevojshëm.

## Gjatë muajit

Kryeministri Haradinaj u takua me përfaqësuesit e SBASHK-ut

### Me angazhime të përbashkëta për korrigjim në Projektligjin e pagave



Duke vazhduar me përpjekjet që të bëhen korrigjime të Projektligjin për pagat në mënyrë që të punësuarit në sektorin e arsimit të kenë vend merit, një delegacion i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj është pritur sot nga Kryeministri Haradinaj. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe Ministrat Mahir Jagcilar e Shyqiri Bytyqi.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut i kanë shprehur edhe një herë Kryeministrit Haradinaj dhe kabinetit të tij kundërshtimin e bazuar të punëtorëve të arsimit ligur me Ligjin e pagave.

"Edhe përkundër angazhimeve tona të vazhdueshme dhe prezantimit të argumenteve tona të bazuara në takimet me Ministrin Jagcilar dhe Bytyqi, versioni i votuar i Ligjit të pagave në takimin e Qeverisë më 3 shtator nuk i ka marrë parasysh vërejtjet e bazuara të

SBASHK-ut kështu që ky ligj është degradues për tërë sistemin arsimor", është shprehur Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj duke kërkuar që Kryeministri të bëjë hapa konkret për realizimin e kërkesës së SBASHK-ut për korrigjim të këtij Projektligji, kurse menaxheri për financa e administratë, Ymer Ymeri është ndalur në shembuj konkret me të cilat ka dëshmuar edhe para Kryeministrit se Projektligji i pagave i ka radhitur gjithë të punësuarit në arsim në një pozitë tepër të ulët duke kërkuar në emër të anëtarësisë së SBASHK-ut që ky Projektligj të korrigojë në mënyrë që punëtorët e arsimit të kenë vend merit.

Kryeministri Haradinaj ka deklaruar se shqetësimet e ngritura nga SBASHK në këtë takim do të shqyrtohen me kujdes dhe se ai dhe Qeveria do t'i rekomandojnë Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që duke e analizuar këtë projektligj të bëjnë përmirësime në mënyrë që pozita e punëtorëve të arsimit pa tjetër të avancohet. Kryeministri Haradinaj është shprehur se Qeveria respekton punën e përkushtuar të punëtorëve të arsimit duke kujtuar edhe angazhimet dhe votimin e Projektligjit për statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

Miliona sindikalistë të arsimit nga Evropa në përkrahje të SBASHK-ut

### Letër mbështetëse e shumë domethënëse e ETUCE

Protesta e SBASHK-ut e organizuar të shtunën më 8 shtator me kërkesën për korrigjimin e Projektligjit të pagave është përcjellë me vëmendje nga gjithë mediet e Kosovës. Në këtë mënyrë opinioni në Kosovë ka marrë një pasqyrë të qartë se punëtorët e arsimit e kulturës me të drejtë po marrin veprime sindikale duke kërkuar vend merit në ligjin e pagave. Ky veprim sindikal ka zgjuar interesim edhe dhe është mbështetur fuqishëm edhe nga Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës. Ata janë të informuar për çdo angazhim dhe veprim të SBASHK-ut

dhe në shenjë përkrahje ETUCE ka publikuar një raport përmbajtësor gazetaresk në faqen e tyre zyrtare duke ua mundësuar kështu të 11 milionë anëtarëve të Unionit të Sindikatave të Arsimit që të njoftohen me këtë veprim sindikal, që nga ata është vlerësuar si i drejtë dhe i organizuar mirë.

ETUCE është shprehur se do të vazhdojë ta përcjell me kujdes gjendjen te ne dhe do të insistojë te institucionet e Kosovës që të përbushin kërkesat legjitime të SBASHK-ut. Po ashtu do shtuar se ETUCE dërgoi edhe letër mbështetëse për SBASHK-

un lidhur me veprimet sindikale që janë ndërmarr dhe do të ndërmerren në të ardhmen në përpjekje për realizimin e kërkesave.

“Të nderuar kolegë, me këtë letër, ETUCE, që përfaqëson 132 Sindikata të Arsimit në të gjitha nivelet e arsimit në 51 shtete, shpreh mbështetjen ndaj jush në grevën paralajmëruese për të kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të negociojë me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (UESCK-SBASHK), lidhur me radhitjen e personelit të arsimit në Projektligjin për Pagat në sektorin publik.”

Propozimet e bëra në projektligjin që do të paraqitet për miratim në Parlamentin nuk janë marrë në konsideratë propozimet e bëra nga sindikata e

arsimit (SBASHK).ETUCE solidarizohet me ju në mbrojtjen e interesave të mësuesve dhe kërkesën për ngritjen e koeficientit të agave për mësuesit, me këtë veprim proteste para ndërtesave të Qeverisë së Kosovës, më 8 shtator “, thuhet veç tjerash në letrën mbështetëse të ETUCE dërguar SBASHK-ut.



## Në Bruksel një ngjarje e veçantë për sindikatat e arsimit të Evropës Zë i fortë e unik në mbrojtje të profesionit të mësuesit

Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës vazhdon me realizimin e planit strategjik të veprimit duke bërë bashkë përfaqësues të sindikatave të arsimit nga e tërë Evropa me qëllim që në debate të hapura e përmes punëtorive të debatohet për situatën aktuale në arsim dhe të gjenden bashkërisht mundësi për mbrojtjen e arsimit dhe ruajtjen e personalitetit të mësuesit në kohën kur në shumë shtete arsimit nuk gëzon përkrahjen dhe mbështetjen e duhur e meritore.



Pjesë e këtyre angazhimeve të ETUCE është vazhdimisht edhe SBASHK-u. Kështu edhe në Konferencën tematike të Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës në Bruksel "Forcimi i kapaciteteve të sindikatave të arsimit për zhvillimin profesional të mësimit dhe dialogun social", delegacioni i

SBASHK-ut ka dhënë kontribut të çmuar duke prezantuar aktualitetin në arsimin e shtetit tonë dhe duke dhënë ide konkrete, që janë pëlqyer nga gjithë të pranishmit.



Në hapje të kësaj Konference, presidentja e Komitetit të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, znj. Christine Blover ka bërë shpalosjen e angazhimeve të ETUCE dhe pastaj ka bërë një vështrim të sfidave me të cilat po kalojnë të punësuarit në arsim kudo në vendet e Evropës. Ajo ka kujtuar edhe një herë se është solidariteti virtut i lartë i sindikatave dhe prandaj edhe në të ardhmen Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës do ta vazhdojë me punën e angazhimit e përbashkët me të

gjithë në shërbim të këtij misioni.



Edhe drejtoresha për Evropë të ETUCE, znj.Suzan Flocken, u është drejtuar pjesëmarrësve të Konferencës duke u ndalur të nevojja që të shihet se sa shtetet gjegjëse ndihmojnë në ngritjen e vazhdueshme profesionale të mësimit dhe sa ato e kanë vërtetë prioritet arsimin. Zonja Flocken u është drejtuar pjesëmarrësve që gjatë gjithë kohës së Konferencës të japin kontributin e tyre, qoftë në seancat plenare, qoftë gjatë punës në grupe, në mënyrë

që Konferenca të sjell konkluzat meritore që do të jenë bazament për angazhimet e ardhme të ETUCE.

Vlen të ceket se delegacioni i SBSHK-ut, i përbëra nga kryetari Rrahman Jasharaj, sekretarja e përgjithshme, Jehona Oruçi dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë dhënë kontribut në punën e grupeve, por edhe në seancat plenare. Ata kanë zhvilluar gjatë pauzave edhe takime me përfaqësues të shumë sindikatave të arsimit nga e tërë Evropa.



## Takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit Edwards përgëzon SBASHK-un për përkushtimin dhe arritjet

Pjesëmarrja në Konferencën "Forcimi i kapaciteteve të sindikatave të arsimit për zhvillimin profesional të mësimit dhe dialogun social", organizuar nga Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) në Bruksel, ishte moment i mirë për delegacionin e SBASHK-ut që të takohet me sekretarin e përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, z. David Edwards.



"Jam i lumtur që po takoj delegacionin e SBASHK-ut, të kësaj sindikate që ka një histori të veçantë dhe krenare për Internacionalen Botërore të Arsimit, që ka 32 milionë anëtarë nga e tërë bota. Kam shumë njohuri për punën dhe angazhimet tuaja në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit nëpër vite e dekada. Paraardhësi im, miku i madh i arsimit dhe i SBASHK-ut, z.Fred Van Liven më ka porositur që të kem kujdes të veçantë për sindikatën tuaj sepse ju këtë e keni merituar dhe e meritoni me punë e përkushtim. Ishim

dhe do të jemi gjithmonë me ju duke u gëzuar bashkë për arritjet tuaja dhe duke ju përkrahur e duke u bërë zëri juaj kurdo që e kërkon nevojja", ka thënë në fillim të takimit me përfaqësuesit e SBASHK-ut, z. Edvards.



Delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj, sekretarja e përgjithshme, Jehona Oruçi dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë informuar Sekretarin e përgjithshëm të EI-së për arritjet dhe sfidat e duke u ndalur te aktualiteti në arsim dhe angazhimet lidhur me Projektligjin e pagave dhe për Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

"Po ashtu kemi ardhur në këtë takim këtu t'ua urojmë detyrën në emër të mijëra anëtarëve të sindikatës sonë dhe jemi të sigurt se edhe me ju dhe

stafin tuaj do të kemi bashkëpunim të vazhdueshëm dhe do ta gjejmë përkrahjen, ashtu si e kishim nëpër vite nga miku ynë i madh Fred Liven. Ne po angazhohemi që të jemi sa më të mirë si sindikalistë në realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim”, është shprehur kryetari Jasharaj, i cili pastaj në merr të gjithë të punësuarve në arsimin e Kosovës i ka bërë

ftesë z. Edwardsit për ta vizituar Kosovën, ftesë të cilën ai e ka pranuar me kënaqësi.

Sekretari i përgjithshëm i EI-së, ka përsëritur se SBASHK-u do të ketë përkrahjen e EI-së në të gjitha angazhimet dhe se është duke pritur informacione për rrjedhën e situatës dhe me kohë Internacionalja Botërore e Arsimit do të reagojë nëse Qeveria e Kosovës nuk përmbush premtimet.

## Edhe një takim tjetër i rëndësishëm në Bruksel

### Sindikatat e Arsimit të Evropës në përkrahje të veprimeve të SBASHK-ut



Krahas angazhimit dhe kontributit në Konferencën "Forcimi i kapaciteteve të sindikatave të arsimit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe dialogun social", organizuar në Bruksel nga Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), delegacioni i SBASHK-ut ka zhvilluar edhe një takim të rëndësishëm me presidenten e Komitetit të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, znj. Christine Blover dhe drejtoreshën për Evropë të ETUCE, znj. Suzan Flocken.



Udhëheqëset e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, që numëron 11 milionë anëtarë, kanë lavdëruar angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut duke shprehur mirënjohje edhe për komunikimin dhe informimin me kohë e të saktë lidhur me situatën e arsimit në Kosovë dhe për angazhimet në tërësi të SBASHK-ut. Zonjat Blover e Flocken i kanë thënë

delegacionit të SBASHK-ut se ato bashkë me tërë stafin e ETUCE po përcjellin situatën aktuale në arsimin e Kosovës dhe të gjithë vendeve të Evropës dhe se do të vazhdojnë me përkrahjen e solidaritetin. Ato kanë shtuar se janë duke përgatitur një agjendë për të vizituar Kosovën dhe disa vende të Ballkanit për të parë nga afër situatën dhe për t'u takuar edhe me institucionet e shteteve me qëllim që të kërkohet nga to respektimi i marrëveshjeve të nënshkruara me sindikatat dhe që të shtohen angazhimet konkrete për realizimin e kërkesave legjitime të sindikatave. Ato pastaj me vëmendje kanë dëgjuar për angazhimet dhe sfidat aktuale të SBASHK-ut në përpjekje për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Menaxheri për financa e administratë, Ymer Ymeri ka dhënë detaje nga angazhimet e SBASHK-ut dhe ka informuar nga afër udhëheqëset e ETUCE për përkushtimin e SBASHK-ut lidhur me korrigjimin e ligjit për paga dhe për përpjekjet e arsyeshme në realizimin e të gjithë kërkesave legjitime të anëtarësisë, kurse kryetari Jasharaj dhe sekretarja e përgjithshme kanë falënderuar mikpritëset për përkrahjen e vazhdueshme që ato dhe gjithë kolegët nga Evropa i kanë dhënë SBASHK-ut duke e mbështetur kurdo që e ka kërkuar nevoja për të dhënë pastaj një informacion lidhur me aktualitetin në arsimin e Kosovës dhe për angazhimet, arritjet dhe sfidat .Në shenjë respekti për punën e përkushtuar të znj. Blover dhe Flocken delegacioni i SBASHK-ut u ka dhuruar portretet e tyre që i ka punuar një mësimdhënës i artit nga Mitrovica e Kosovës. Dy kryesindikalistet e arsimit të Evropës janë ndjerë të lumtura për dhuratat duke i çmuar si shumë të veçanta dhe domethënëse për to.